

Trajnim në temë “Komunikim dhe zgjidhja e konflikteve dhe zhvillimi i qasjes multietnike për marrëdhëniet me publikun”

Më 23 dhe 24 maj të vitit 2008 në Mavrovë u mbajt trajnim në temë “Komunikim dhe zgjidhja e konflikteve dhe zhvillimi i qasjes multietnike për marrëdhëniet me publikun” në të cilën morën pjesë gjithsej 28 pjesëmarrës nga Shkupi dhe Tetova. Mes pjesëmarrësve kishte përfaqësues nga institucione lokale (9) dhe përfaqësues nga sektori joqeveritar (19). Trajnimin e realizuan Pavlina Jankulovska dhe Mimoza Bogdanovska Jovanovska.

Edhe përpos numrit të madh të pjesëmarrësve në trajnim sundoi një atmosferë e shkëlqyer pune në të cilën temat e parapara u kaluan pa ndërprerje. Gjatë ditës së parë pjesëmarrësit fituan dituri dhe shkathtësi për komunikimin e pa dhunshëm, dialogu dhe dëgjimi i kontrolluar, relativiteti i perceptimit personal, ballafaqimi me paragjykimet e tjetrit, kuptimi i konflikteve në një shoqëri multietnike, frika nga konfliktet dhe teknikat për ballafaqim në situata kanosëse. Gjatë trajnimit kishte një komunikim spontan dhe jo të dhunshëm mes pjesëmarrësve, edhe pse bëhej fjalë për tema dhe ushtrime në të cilat u simuluan situata të ndryshme konflikte që shfaqen në një shoqëri multietnike. Disa pjesëmarrës maksimalisht u mishëruan me rolet e tyre duke treguar shkathtësi në lojërat dhe në këtë mënyrë kontribuan për arritjen e rezultateve të dukshme dhe realizimin e suksesshëm të përmbajtjeve.

Gjatë ditës së dytë u përfshinë temat në vijim: ndërmjetësimi në konflikte dhe ndërmjetësuesit, identiteti nacional dhe dallimet, ballafaqimi me dallimet, krijimi i ndjenjës së besimit, aktivitete për komunikim, agjitimi në mediume dhe përzgjedhja e metodave për marrëdhënie me opinionin. Ushtrimet për njoftim u pranuan nga të gjithë pjesëmarrësit dhe kontribuan që ata më lehtë të adaptohen në grup, kurse ata pjesëmarrës të cilët deri atëherë kanë marrë pjesë në trajnime të ngjashme propozuan lojëra të reja në të cilat me kënaqësi u kyçën edhe të tjerët. Në këtë mënyrë pjesëmarrësit treguan nivel të lartë të sinergjisë. Në kuadër të vlerësimit gojor u dhanë komentet në vijim: ...tema është super, më vjen mirë që organizatori ka propozuar një temë të tillë, mësova shkathtësi të reja; ...trajnimi i realizuar në mënyrë shumë efikase, mundësi e rrallë të jemi kështu bashkë më shumë organizata nga përkatësi të ndryshme nacionale, etj.

Trajnimi u mbulua nga redaksia boshnjake pranë MTV-s, kurse të njëjtën e organizoi Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me organizatën partnere “Vlera të përbashkëta” nga Shkupi.